



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.436/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi, kryesues, Hajriz Hoti, dhe Violeta Husaj Rugova, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, parashtruar kundër koalicionit AAK-NISMA, me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.02.2025, merr këtë :

V E N D I M

HEDHET e palejuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, Anr.436/2025 datë 07.02.2025 parashtruar kundër Koalicionit AAK-NISMA, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

A r s y e t i m

Me datë 07.02.2025 PZAP ka pranuar një ankesë nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, në të cilën pretendohet se më 07.02.2025 aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore, kanë identifikuar veprime nga kandidati për deputet i radhëve të koalicionit AAK-NISMA, z.Besnik Krasniqi në kundërshtim me legjislacionin zgjedhor në fuqi kur ka postuar në facebook, i cili vazhdon të jetë aktiv, konkretisht i njëjti ka renë ndesh me nenin 5 të Rregullorës Zgjedhore me nr.07/2024 e cila ndalon pjesëmarrjen e të punsuarve në institucione fetare gjatë fushatës zgjedhore. Parashtruesi i ankesës thekson se është berë shkelje nga kandidati i koalicionit AAK-NISMA z.Besnik Krasniqi pasi që i njëjti e shfrytëzon këtë takim me Sheh Sinan Shishko në teqën e tarikatit Sinan pikërisht për fushatën zgjedhore.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur Foto nga takimi me tekstin avokues për fushatë zgjedhore.

PZAP-i, e njoftoi koalicionin AAK-NISMA, për ankesën e parashtruar kundër tyre.

Në përgjigjen në ankesë të datës 08.02.2025, koalicionin AAK-NISMA ka theksuar se ankuesi në ankesën e paraqitur nuk ka theksuar fare kohën në të cilën pretendohet të jetë kryer shkelja nga z.Besnik Krasniqi dhe e gjithë ankesa e parashtruar mbështetet në screenshot të postimit të z.Besnik Krasniqi të postuar 17 orë më parë, mirëpo nga provat e ofruara nga ankuesi nuk vërtetohet se 17 orë më parë nga cili moment është bërë postimi në

fjalë dhe sa orë pas marrjes së kushtimisht të themi provës-screenshot është paraqitur në PZAP, rrjedhimisht ankesa mund të jetë paraqitur pas afatit të përcaktuar me LPZ.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se :

-Ankesa është e pa lejuar.

Paneli pasi që shqyrtoi ankesën e parashtruar nga ana e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, konstatoi se ankesa është e palejuar, pasi që ankesa e parashtruar nga ana e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV) nuk i përmban të gjitha elementet që duhet të ketë një ankesë, gjegjësisht nuk është e nënshkruar nga ana e personit ankues.

Në nenin 5.1.7 të Rregullores nr.01/2024 për procedurat e parashtrimit, dhe vendosjes së ankesave ndër të tjera thuhet se : ***“Ankesa që dorëzohet në PZAP për shqyrtim duhet të përmbajë këto të dhëna : ...1.7. nënshkrimin e personit ankues”.***

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 7, dhe nenin 13 par.3 të Rregullores nr.01/2024, për procedurat e parashtrimit dhe vendosjes së ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Anr.436 /2025 datë 05.02.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes - pranimi të këtij vendimi.